

URDHËR
Nr. 99/2, datë 29.6.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021, “PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BREDA VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, germa “d”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 2435, datë 27.5.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit togfjalëshi “nga ora 23:00” zëvendësohet me togfjalëshin “nga ora 24:00”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.7.2021, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu